



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dop. Dop. Dop.	Nr. Prot. Sj. Prot. Prot. No.
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
PRISHTINE	

DPK/00P
2/72
03/2468/12
19.07.2012



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRIZREN/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U PRIZRENU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRIZREN

Nr.12789/2011

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRIZREN me gjykatësin **Nazim Vllaçon** e me procesmbajtësen **Shqipe Simitçiun**, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës Lumnije Hoxha nga Prizreni, për shkak të kundërvajtjes nga neni 6 parag.1 të ndëshkuar sipas nenit 16 parag.1 p.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik nr.03/L-151, e në bazë të nenit 195 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me datën 22.06.2012

A K T V E N D I M

E pandehura Lumnije Hoxha, nga i ati Sejdi, e lindur më 1954 në Mitrovicë tani me vendbanim në Prizren në rrugën Dalmatët nr.34, me kombësi shqiptare, oftamologe, me fakultet të kryer të mjekësisë, e martuar nënë e dy fëmijëve, e gjendjes së mesme e padënuar për kundërvajtje, Drejtoreshë e Departamentit Shëndetësor në Spitalin e Prizrenit.

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S E

Sepse si Zyrtare e Lartë Publike, Drejtoreshë e Departamentit Shëndetësor në Spitalin Regional të Prizrenit, nuk e ka bërë deklarin e rregullt vjetor të pasurisë për vitin 2010 nga parag.1 të nenit 5 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen, Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik

-me të cilën veprim ka kryer kundërvajten nga neni 6 parag.1 të ndëshkuar sipas nenit 16 parag.1 p.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik nr.03/L-151, e për këtë shpiktohet sanksioni i

Q O R T I M I T

A r s y e t i m

Me kërkesën e Agjencisë kundër Korrupsionit të Republikës së Kosovës me nr.01-3238/11 të dates 12.07.2011 u zhvillua procedura kundërvajtëse kundër të pandehurës Lumnije Hoxha nga Prizreni, për shkak të kundërvajtjes nga neni 16 parag.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik nr.03/L-151.

Gjendja faktike e përshkruar më përseafërmi si në dispozitiv të këtij aktvendimi është vërtetuar në bazë të deklaratës së të pandehurës, përfaqësuesit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, deklaratës së dëshmitarit Myzafer Kalanderi-Drejtor i Spitalit Regjional i Prizrenit si dhe me administrimin e provave tjera në shkresat e lëndës.

E pandehura në deklaratën e saj ka theksuar se nuk ka qenë në dijeni lidhur me datën e fundit të deklarimit të pasurisë Agjencisë kundër Korrupsionit dhe ka mohuar të ketë qenë e paisur me formularë për deklarimin e pasurisë dhe se e njëjta ka theksuar se pas njoftimit nga ana e drejtorit Ekzekutiv të Spitalit Myzafer Kalanderi menjëherë kishte shkarkuar formularët nga interneti dhe me datën 13.09.2011 kishte dërguar formularët Agjencisë kundër Korrupsionit për Deklarim vjetor të pasurisë.

Në cilësi të dëshmitarit është marrë deklarata e përfaqësuesit të Agjencisë kundër Korrupsionit Afrim Atashi. Përfaqësuesi i AKK në deklaratën e vetë ka theksuar se AKK me datën 07.03.2011 ka njoftuar Zyrtarët e Lartë Publik lidhur me deklarimin e pasurisë së tyre ku është cekur se data e fundit të deklarimit të pasurisë është 31.03.2011.

Me qëllim të vërtetimit sa më të plotë të gjendjes faktike gjykatësi me shkresën nr.12789/2011 të datës 11.01.2011 dhe 15.03.2011 ka kërkuar plotësim nga Ministria e Shëndetësisë lidhur me kundërvajtjen që i vihet në barrë të pandehurës ndërkaq me datën 11.04.2012 nga Ministria e Shëndetësisë është marrë njoftimi se Zyrtari i Lartë i Personelit të Ministrisë dhe të Shëndetësisë Haki Smajli më datën 08.03.2011 me anë të imellit Zyrtar kishte njoftuar drejtorin e Regjional të Spitalit Myzafer Kalanderit lidhur me plotësimin e formularëve për deklarimin e pasurisë dhe obligimin e tij që ta bëjë shpërndarjen e formularëve për Zyrtarët e Lartë të cilët janë në deklarimin e pasurisë.

Në cilësi të dëshmitarit është marrë deklarata e Drejtorit të Spitalit Myzafer Kalanderi i cili në deklaratën e vetë ka theksuar se kompetentët e Ministrisë së Shëndetësisë nuk kishte pranuar kurrfarë njoftimi apo formularë për Deklarimin e pasurisë vjetor për Zyrtarë të Lartë andaj edhe nuk ka pasur mundësi objektive që lidhur me deklarimin e pasurisë ta njoftonte të pandehurën Lumnije Hoxha për këtë obligim ligjor dhe për këtë edhe vetë nuk e kishte bërë deklarimin vjetor të pasurisë dhe posa ishte njoftuar me ftesë të gjykatës e kishte lajmëruar të pandehurën që ta bëjë Deklarimin e Pasurisë Agjencisë kundër Korrupsionit.

Gjykatësi ka vlerësuar mbrojtjen e të pandehurës por të njëjtën e ka cilësuar si shmangie nga përgjegjësia dhe për këtë është shpallur përgjegjëse për kundërvajtjen që i vihet në barrë por ndaj të njëjtës i është shqiptuar sanksioni i QORTIMIT në kuptim të nenit 10 të Ligjit mbi Kundërvajtjet ngase ekzistojnë rrethanat që në masë të konsiderueshme e zvogëlojnë përgjegjësinë e kryesit të kundërvajtjes ashtu që mund të pritët se pa dhënjën e dënimit e pandehura nuk do të bëjë kundërvajtje.

Me shqiptimin e kësaj mase si rrethanë është marrë parasysh fakti se e pandehura gjerë më tani nuk ka qenë e dënuar për kundërvajtje dhe nuk ka prova se njëjta të ketë qenë e njoftuar me kohë nga ana e Drejtorit të Spitalit për Deklarim të Pasurisë faktin se pas njoftimit gojor nga ana e Drejtorit më datën 13.09.2011 e kishte bërë Deklarimin Vjetor të Pasurisë i cili fakt mund të konstatohet në bazë të shqimit të bërë Agjencisë kundër Korrupsionit me nr.03/3667/11 të datës 20.09.2011.

Shpenzimet e procedurës janë të caktuar në bazë të nenit 109 al.2 të Ligjit mbi kundërvajtjet.

Me sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të aktvendimit.

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRIZREN

Dt.22.06.2012

Procesmbajtësja
Shqipe Simitçiu

Nr.12789/2012

Gjyqtari
Nazim Vllaça

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi e në afat prej 8 ditësh nga dorëzimi mund të ushtrohet ankesa Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nëpërmes të kësaj gjykate pa taksa.